

Vendim nr. 67 datë 04.04.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari, Kryesuese

Sandër Beci, Anëtar

Marjana Semini, Anëtare

në datën 04.04.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 1 (R) 2023 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: RAMAZAN REXHA

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 12913, datë 27.12.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 1279, datë 08.04.2014 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2022-2118, datë 22.06.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
Kthimi i çështjes për t'u gjykuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 41, pikat 1 dhe 2, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (Kolegji), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Ramazan Rexha, në cilësinë e trashëgimtarit ligjor, ka fituar të drejtën e bashkëpronësisë në masën 1/8-n pjesë takuese të një pasurie të llojit truall, me sipërfaqe të përgjithshme 2799 m². E drejta e pronësisë për këtë pasuri i është njohur trashëgimlënësit të kërkuesit, në cilësinë e subjektit të shpronësuar, bazuar në ligjin e kthimit dhe kompensimit të pronave.

2. Nëpërmjet kontratës noteriale të dhurimit të datës 07.06.1997, kërkuesi ka përfituar prej dy trashëgimtareve ligjore pjesët takuese të tyre, në masën 1/8-n secila. Po kështu, me kontratën noteriale të dhurimit të datës 10.06.1997, ai ka përfituar edhe pjesën takuese të një trashëgimtareje tjetër. Për rrjedhojë, pjesa e tij takuese në pronën truall është rritur në 4/8-n pjesë. Me kontratën e pjesëtimit vullnetar të datës 25.06.1997, kërkuesi ka rezultuar pronar i sipërfaqes së lirë në S2 për 652 m² dhe në S6 për 117 m². Këto veprime janë pasqyruar edhe në regjistrin e pasurive të paluajtshme pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë.

3. Kërkuesi, në cilësinë e porositësit, ka lidhur kontratën e sipërmarrjes, datë 29.12.2005, për ndërtimin e një godine shumëkatëshe në truallin me sipërfaqe 810 m², regjistruar në regjistrin hipotekor nr. 27, datë 23.10.2003. Për ndërtimin e kësaj godine, Këshilli i Rregullimit të Territorit të Bashkisë Tiranë, me vendimin nr. 103, datë 07.06.2008, ka lëshuar lejen e ndërtimit dhe ka miratuar sheshin e ndërtimit.

4. Në vijim, një nga trashëgimtarete ligjore të subjektit të shpronësuar ka ngritur padi në gjykatë duke kërkuar: (i) pavlefshmërinë absolute të kontratës noteriale të datës 07.06.1997; (ii) pavlefshmërinë absolute pjesërisht të kontratës së sipërmarrjes së datës 29.12.2005; (iii) si dhe rregullimin e pasojave me qëllim përfitimin e sipërfaqeve ndërtimore në raport me pjesët takuese të pronës.

5. Fillimisht, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 1408 akti, datë 22.04.2011, ka vendosur masën e sigurimit të padisë mbi sipërfaqen 162 m², në pasurinë në emër të kërkuesit. Vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 24, datë 01.02.2012.

6. Më tej, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 12913, datë 27.12.2012, ka vendosur pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë, detyrimin e kërkuesit t'i dorëzojë trashëgimtares tjetër ligjore sipërfaqet ndërtimore prej 52.32 m² nëntokë; 23.78 m² kati përdhe dyqane dhe 122.86 m² apartamente banimi, si dhe ligjërimin e masës së sigurimit. Gjykata ka arsyetuar se veprimi juridik është kryer në kundërshtim me dispozitat urdhëruese ligjore materiale,

pasi kontrata e dhurimit nuk përmban nënshkrimin e paditëses, por vetëm është vendosur një gjurmë gishti dhe është nënshkruar nga një avokate, ndërkohë që në bazë të nenit 82 të Kodit Civil, kontrata duhej të ishte nënshkruar nga një person tjetër i ngarkuar nga personi në pamundësi për të nënshkruar dhe nënshkrimi i këtij personi duhej të vërtetohej nga noteri. Sipas gjykatës, nga sipërfaqja prej 652 m² të vendosur në dispozicion të shoqërisë ndërtuese, 163 m² i takojnë trashëgimtares ligjore që kishte ngritur padinë.

7. Mbi bazën e ankimit të kërkesit, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1279, datë 08.04.2014, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, me arsyetimin se ajo ka analizuar në mënyrë të hollësishme rrethanat e faktit, ka përcaktuar drejt dispozitat ligjore për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, ka përmbushur kërkesat e një procesi të rregullt ligjor dhe ka zhvilluar një hetim të plotë e të gjithanshëm të çështjes. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs kërkesi.

8. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-2118, datë 22.06.2022, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se ai nuk përmban asnjërin prej rasteve të parashikuara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile. Sipas Gjykatës së Lartë, gjykatat e faktit kanë respektuar kërkesat e ligjit material, duke e interpretuar dhe zbatuar drejt atë, kanë arsyetuar në mënyrë ezauruese shkakun e vendimmarrjes dhe nuk rezulton të ketë zbatim të gabuar të ligjit procedural. Po kështu, Gjykata e Lartë është shprehur se pretendimet që lidhen me vlerësimin e provave dalin jashtë juridiksionit rishikues dhe ekskluzivisht ligjor të saj.

9. Në datën 30.01.2023 kërkesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, për shfuqizimin e vendimeve të të tria gjykatave, si të papajtueshme me Kushtetutën, si dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në gjykatën e shkallës së parë, sipas arsyetimit të kësaj Gjykate.

II

Pretendimet e kërkesit

10. **Kërkesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta e pronës private, e garantuar nga neni 41, pikat 1 dhe 2, të Kushtetutës, pasi gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit nuk kanë analizuar drejt qëllimin dhe vullnetin e shprehur në kontratën e dhurimit.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkesit

11. Çështja e legjitimit (locus standi) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

12. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyimit kushtetues.

13. Kolegji vlerëson se kërkuesi, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në Kushtetutë, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë e paditur në procesin gjyqësor në të cilin janë dhënë vendimet objekt kundërshtimi në Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

14. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese që pretendohet se janë cenuar. Në nenin 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000, përmbushja e këtij kriteri është detajuar në dy hipoteza: i) kur kërkuesi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike efektive para se t’i drejtohet gjykatës; ii) kur legjislacioni i brendshëm nuk parashikon mjete efektive në dispozicion.

15. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, individ i mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr. 35, datë 01.11.2021; nr. 33, datë 01.11.2021; nr. 38, datë 25.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Në çështjen konkrete, kërkuesi kundërshton vendimet gjyqësore të dhëna nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm gjatë gjykimit të padisë për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratës së dhurimit dhe rregullimin e pasojave të saj, të përfunduar me vendimin nr. 00-2022-2118, datë 22.06.2022 të Gjykatës së Lartë. Në këtë situatë, Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk ka më mjete të tjera ankimi ndaj vendimeve të kundërshtuara dhe, për rrjedhojë, ai e ka përmbushur kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion.

17. Gjithashtu, Kolegji çmon se kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi e ka paraqitur ankimin kushtetues individual brenda afatit 4-mujor, të përcaktuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000. Më konkretisht, ankimi është paraqitur në Gjykatë në datën 30.01.2023, ndërsa vendimi i Gjykatës së Lartë i dhënë në datën 22.06.2022 është përcjellë nëpërmjet njoftimit elektronik në adresën e avokatit të tij në datën 30.09.2022.

18. Për sa i takon legjitimitet *ratione materiae*, Kolegji vëren se kërkuesi ka pretenduar se gjykatat i kanë cenuar të drejtën e pronës private, të garantuar nga neni 41, pikat 1 dhe 2, të Kushtetutës, pasi ato nuk kanë analizuar drejt qëllimin dhe vullnetin e shprehur në kontratën e dhurimit, objekt i mosmarrëveshjes gjyqësore. Këto elemente, bazuar në dispozitat e ligjit nr. 7829, datë 01.06.1994 “Për noterinë” dhe Kodin Civil, nuk mund të eliminohen, pavarësisht paraqitjes grafike të kontratës së dhurimit.

19. Mbështetur në thelbin e argumenteve të parashtruara nga kërkuesi, Kolegji konstaton që ato, pavarësisht se mbështesin pretendimin për cenimin e së drejtës kushtetuese të pronës private, kanë të bëjnë me përcaktimin e fakteve nëpërmjet provave të shqyrtuara në gjykim, si dhe zbatimin e ligjit për zgjidhjen e mosmarrëveshjes gjyqësore. Në këtë këndvështrim, Kolegji sjell në vëmendje se Gjykata në jurisprudencë të vazhdueshme ka theksuar se vlerësimi i fakteve dhe rrethanave, si dhe interpretimi i ligjit dhe zbatimi i tij në çështjet konkrete, e ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Megjithatë, Gjykata ndërhyr në ato raste kur gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, përmes interpretimit dhe zbatimit të ligjit në një çështje konkrete, kanë cenuar të drejtat kushtetuese të palëve. Në këto raste, Gjykata nuk bën rivlerësimin e fakteve e të rrethanave, por një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 40, datë 22.12.2022; nr. 2, datë 17.02.2022; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Me fjalë të tjera, detyra e kësaj Gjykate është të shqyrtojë dhe vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me

garancitë kushtetuese të parashikuara në nenet 41 dhe 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 40, datë 22.12.2022; nr. 33, datë 14.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Nën dritën e standardeve të mësipërme, Kolegji vëren se kërkuksi në ankimin kushtetues individual kundërshton mënyrën se si gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë përcaktuar faktet dhe rrethanat që lidhen me vlefshmërinë në formë dhe në përmbajtje të kontratës së dhurimit, si në drejtim të përcaktimit të palëve pjesëmarrëse, ashtu edhe në drejtim të mënyrës së nënshkrimit të këtij akti prej tyre. Gjithashtu, kërkuksi ka kundërshtuar mënyrën se si gjykatat kanë interpretuar dhe zbatuar, në rastin konkret, dispozitat ligjore materiale të ligjit për noterinë të lidhura me ato të Kodit Civil. Ndërkohë, nuk rezulton që ai të ketë ngritur pretendime se zbatimi i ligjit nga gjykatat ka qenë eventalisht arbitrar, por është mjaftuar me argumentin se mënyra se si gjykatat kanë zgjidhur mosmarrëveshjen objekt gjykimi i ka cenuar atij të drejtën e pronës private. Kjo e fundit ka qenë objekt vlerësimi nga gjykatat e juridiksionit të zakonshme, të cilat bazuar në provat e shqyrtuara, si dhe në interpretimin e ligjit të zbatueshëm, për rastin në shqyrtim, kanë përcaktuar se kujt dhe deri në çfarë mase i takon kjo e drejtë. Në këtë mënyrë ato kanë kryer rolin e tyre në përcaktimin e fakteve dhe zbatimin e ligjit me qëllim zgjidhjen e drejtë të mosmarrëveshjes gjyqësore.

21. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se argumentet e parashtruara nga kërkuksi në ankimin kushtetues individual nuk janë ngritur në nivel kushtetues për t'i hapur rrugë kontrollit kushtetues.

22. Në përfundim të analizës për kriteret paraprake, Kolegji çmon se çështja nuk mund të kalojë për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.